



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Prishtinë, 19 shkurt 2010
Nr.ref.: RMP 16/10

Vendim lidhur me Kërkesën për Masë të Përkohshme

në

Rastin nr. KI 68/09,

Emrush Kastrati

kundër

Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Pkl. Nr. 120/08, të datës 1 shtator 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbëre nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Pas shqyrtimit të kërkesës për masë të përkohshme të parashtruesit të kërkesës, Emrush Kastrati, Gjykata miraton njëzëri **Vendimin** në vijim, pa paragjykim për vendimet tjera të cilat Gjykata do t'i merr lidhur me lejueshmërinë apo meritat e lëndës:

Hyrje

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Emrush Kastrati, Gjyqtar i Gjykatës Komunale në Malishevë, nga rr. Hamdi Berisha, p.n., lagjja Mirdita, në Malishevë.

Vendimi i sfiduar

2. Vendim i sfiduar nga parashtuesi i kërkesës është Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. Nr. 120/08, i datës 1 shtator 2009.

Çështja e lëndës

3. Më 3 dhjetor të vitit 2009, parashtuesi i kërkesës, Emrush Kastrati, parashtoi kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke kërkuar shqiptimin e masës së përkohshme kundër zbatimit të Aktvendimit të Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 120/08, të datës 1 shtator 2009, në bazë të asaj se Gjykata Supreme me marrjen e këtij aktvendimi ka cenuar pavarësinë e gjyqësorit.
4. Parashtuesi i kërkesës pohon se Aktvendimi në fjalë shkel Nenin 107.1 të Kushtetutës së Kosovës, i cili përcakton imunitet gjyqësor dhe prokurorial. Në nenin 107, theksohet si në vijim:

Neni 107 [Imuniteti]

1. Gjyqtarët, përfshirë edhe gjyqtarët porotë, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësi të tyre si gjyqtarë.

2. Gjyqtarët, përfshirë edhe gjyqtarët porotë, nuk gëzojnë imunitet dhe mund të shkarkohen nga funksioni, kur të kenë shkelur ligjin me qëllim.

3. Kur një gjyqtar akuzohet ose arrestohet, duhet të njoftohet pa vonesë Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Baza juridike

5. Neni 116.2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 27 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (më tej *ligji*) dhe neni 52.1 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese (më tej *rregullorja*).

Faktet

6. Prokuroria Publike Komunale e Prizrenit ngriti aktakuzë kundër parashtuesit të kërkesës, nr. 2085/2008, të datës 27 gusht 2008, për vepër penale të lëshimit të vendimit joligjor gjyqësor, në bazë të nenit 346 të Kodit Penal të Kosovës.
7. Gjykata Komunale e Deçanit, si gjykatë penale e shkallës së parë, me Aktvendimin KA. Nr. 14/2009, gjithashtu të datës 27 gusht 2008, përmbysi aktakuzën e paraqitur nga Prokurori Publik, për shkak se nuk kishte dëshmi të mjaftueshme për të përkrahur dyshimin e bazuar se parashtuesi i kërkesës kishte kryer veprën penale me të cilën ngarkohej.
8. Me Aktvendimin KA.nr.14/2008, të datës 7 tetor 2008, kolegji i Gjykatës Komunale të Deçanit, vërtetoi këtë vendim dhe hodhi poshtë ankesën të cilën e kishte paraqitur Prokurori Publik kundër vendimit original të Gjykatës Komunale.
9. Më 1 shtator 2009, Gjykata Supreme e Kosovës, duke ushtruar revizionin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtuar nga Prokurori Publik kundër atij aktvendimi, lëshoi Aktgjykimin PKL.no.120/08, me të cilin e shpall kërkesën për

shqyrtim të ligjshmërisë si të bazuar, dhe vlerëson se Vendimi i kontestuar, i cili ishte në favor të parashtruesit të kërkesës nuk ishte në pajtim me interpretimin adekuat të neneve 304 dhe 316 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Konkluzion

10. Pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit Raportues, Iliriana Islami, dhe pas shqyrtimit të lëndës më 19 shkurt 2010, Gjykata arrin tek përfundimi se kërkesa për masë të përkohshme duhet refuzuar. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi apo arsye të mjaftueshme për të arsyetuar pengimin e procedurës penale që zhvillohet në Gjykatën Komunale. Parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se masat e përkohshme janë të domosdoshme për t'iu shmangur ndonjë rreziku të papërmirësueshëm apo se masat e tilla të përkohshme janë në interes publik, gjë që kërkohet me nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Pa paragjykuar vendimet tjera që do merren lidhur me pranueshmërinë ose meritat e lëndës, në pajtim me Nenin 27 të Ligjit dhe Nenin 52.1. të Rregullores, Gjykata Kushtetuese, në seancën e datës 19 shkurt 2010, njëzëri:

VENDOS

- I. Të refuzojë kërkesën për masë të përkohshme;
- II. Ky Vendim do t'i njoftohet palëve;
- III. Ky vendim do të publikohet, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja Raportuese

Dr. Iliriana Islami, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.